



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 2523 prot.

Shkodër, më 25.08.2023

V E N D I M

Nr. 193, datë 25.08.2023

"Për përfshirje në buxhetin 2023 të projektit "Laboratori klinik-biokimik"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 12, pika 6, Neni 38, pika 1, germa h; Statutin e USH-së Neni 17, pika 6, germa c dhe ç, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 25.08.2023

Vendosi:

1. Përfshirjen në buxhetin e vitit 2023 të projektit "Laboratori klinik-biokimik" sipas kontratës Nr.2180/1 prot datë 17/07/2023, bashkëlidhur.
2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Prof. Dr. ~~Rajmonda KEÇI~~ **KEÇI SIRA**





Prot. 2180/1
17.07.2023



9. SHK
Administracioni
Mirela

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PROGRAMEVE KOMBËTARE

Nr. 825/2 prot.

Tiranë, më 14.07.2023

Lënda: Përcjellje e kontratës


ZNJ. RAJMONDA KËRÇIRA
REKTOR
UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI", SHKODËR

SHKODËR

E nderuar Znj. Kërçira,

Bashkëngjitur gjeni ju lutem, kontratën e nënshkruar të financimit të projektit të Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër, me titull "Laboratori Klinik Biokimik.", të aplikuar në kuadër të Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH) për vitin 2023, së bashku me planin e financimit dhe planin e aktiviteteve.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,





KONTRATË

E lidhur sot, më datë 11.07.2023 ndërmjet palëve kontraktuese si më poshtë:

Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), me adresë Rruga "Naim Frashëri", Nr. 37 Tiranë, në cilësinë e **Financuesit**, përfaqësuar nga Znj. Mirela Muça, Drejtor i Përgjithshëm, me numër të letërnjoftimit G25912076S.

Dhe

Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër, liçensuar me Vendimin Nr. 150, datë 18.04.1957, të Këshillit të Ministrave, në cilësinë e **Përfituesit**, përfaqësuar nga rektori në detyrë Znj. Rajmonda Kërçira¹, me numër të letërnjoftimit F96030050E.

Palët në këtë kontratë bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Baza ligjore

Kjo kontratë lidhet në bazë të neneve 109 -113 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit nr. 607, datë 31.8.2016 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit", Vendimit nr.75, dt. 12.2.2018, "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor" të Këshillit të Ministrave, si dhe Vendimit Nr. 8, datë 16.06.2023, "Për miratimin e financimit të projekteve të infrastrukturës së kërkimit shkencor, për vitin 2023" të Bordit të Administrimit të AKKSHI- së.

Neni 2

Objekti i Kontratës


Objekti i kësaj Kontrate është financimi nga AKKSHI, në formë granti, për zbatimin e Projektit me titull: "Laboratori Klinik Biokimik.", paraqitur nga Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, me drejtuese projekti Dr. Lulzime Dhora.

Neni 3

Periudha

1. Kjo Kontratë hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj nga palët dhe përfundon me realizimin e të gjitha aktiviteteve të Projektit. Kontrata përfundon me dorëzimin e raportit përfundimtar të projektit nga Përfituesi dhe pranimin e këtij raporti nga Financuesi (AKKSHI).

¹ Urdhër Nr. 313, datë 22.06.2023 MAS.

- 
2. Zbatimi i kontratës fillon nga data e kalimit të fondit në llogarinë e Përfituesit. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Përfituesi detyrohet të dorëzojë në rrugë zyrtare, buxhetin e rishikuar dhe kalendarin e aktiviteteve të projektit.

Neni 4

Shuma dhe mënyra e Financimit të Projektit

Bazuar në Vendimin Nr. 8, datë 16.06.2023 të Bordit të Administrimit, AKKSHI-ja do të mbështesë financiarisht zbatimin e projektit me 8,000,000 (tetë milion) lekë.

Me lidhjen e kësaj kontrate, kjo shumë me specifikimet përkatëse (titulli i projektit dhe njësisë zbatuese), do të kalojë në llogarinë e përfituesit.

Neni 5

Detyrimet e përfituesit

Përfituesi i grantit të financimit të projektit ka detyrimin që:

1. Të shpenzojë fondet sipas buxhetit të miratuar në përputhje me formën e planifikimit financiar të projektit që i bashkëlidhet kësaj kontrate.
2. Të kthejë në buxhetin e shtetit, të gjitha fondet e pashpenzuara brenda 15 ditësh pas përfundimit të projektit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.
3. Të dorëzojë pranë AKKSHI-së raportet (e ndërmjetme dhe përfundimtare) teknike dhe financiare, shoqëruar me dokumentacionin përkatës ashtu siç është përcaktuar në nenin 6 të kësaj kontrate.

Neni 6

Raportimi

1. Gjatë zbatimit të projektit, përfituesi i grantit raporton lidhur me ecurinë e zbatimit të projektit sa herë që kjo i kërkohet nga AKKSHI. Forma e raportimit përcaktohet nga AKKSHI.
2. Në përfundim të zbatimit të projektit, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune, përfituesi i grantit dorëzon në AKKSHI, në 3 (tri) kopje, raportin përfundimtar teknik të realizimit të projektit, shoqëruar me shkresë përcjellëse nga rektori i institucionit të arsimit të lartë përfitues i grantit.
3. Raporti përfundimtar hartohet sipas formatit të AKKSHI dhe duhet të përmbajë:
 - a. Raportin përshkruar sipas formatit të përcaktuar nga AKKSHI;
 - b. Raportin financiar, sipas formatit të përcaktuar nga AKKSHI. Raporti financiar duhet të shoqërohet me kopje të dokumentacionit të plotë të prokurimit dhe të blerjes së infrastrukturës kërkimore - shkencore, me kopje të faturave të shpenzimeve si dhe foto/video të pajisjeve pjese e te infrastrukturës kërkimore - shkencore. Ky raport duhet të firmoset nga drejtuesi i projektit, financieri, administratori dhe rektori i institucionit të arsimit të lartë përfitues i grantit.
4. Pas dorëzimit të raportit përfundimtar final, AKKSHI kontrollon nëse raporti dhe i gjithë dokumentacioni shoqëruar është hartuar sipas kritereve të kërkuara.
 - a. në rast se raporti përfundimtar është kryer sipas kërkesave, institucioni përfitues merr konfirmimin nga AKKSHI për përmbylljen me sukses të projektit dhe shlyerjen e të gjitha detyrimeve që ka patur në kuadër të zbatimit të tij;



- b. në rast të konstatimit të parregullsive, njoftohet përfituesi i grantit për plotësimin / korrigjimin e dokumentacionit brenda 5 (pesë) ditë pune.
5. Në rastin kur institucioni përfitues i grantit shkel detyrimin lidhur me raportimet, AKKSHI kërkon auditimin e shumës së përfituar, deri në kthimin e tij në buxhetin e shtetit.

Neni 7

Të dhëna bankare të përfituesit:

- a. Emri i përfituesit të grantit Uhi vobsi toja LLC qj Gura e Kallit
- b. Llogaria/ kodi thesarit 1011129/3333

Neni 8

Përgjegjësia e Përfituesit

Përfituesi është subjekti përgjegjës për kryerjen me efektivitet të projektit sipas Formularit të Projekt Propozimit të Plotë dhe formës së planifikimit financiar të projektit fitues.

AKKSHI-ja nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmtime apo ankesa të shkaktuara nga dhe nëpërmjet projektit. Përfituesi mban të gjithë përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

Nëse gjatë realizimit të projektit, përfituesi i grantit përballet me situata që mund të çenojnë realizimin e projektit sipas planifikimit, zbatimin në kohë të aktiviteteve të parashikuara në projekt ose ndërprerjen e tyre, ai njofton menjëherë AKKSHI-në.

Të gjitha përgjegjësitë që lidhen me procesin e prokurimit, blerjes, vënies në punë dhe përdorimit të pajisjeve dhe mjeteve të blera me këtë grant në kuadër të projektit, janë të përfituesit.

Neni 9

Monitorimi/Kontrolli

1. Për çështjet që i takojnë monitorimit të objektit të kësaj Kontrate, përfituesi duhet t'i përgjigjet kërkesës së financuesit për monitorim të ecurisë së projektit, brenda 10 (dhjetë) ditë pune nga dorëzimi i kërkesës.
2. Përfituesi duhet të ofrojë akses në institucion për monitoruesit e AKKSHI-it pas njoftimit paraprak të këtyre të fundit dhe të ofrojë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar lidhur me projektin (duke përfshirë informacionin financiar). Kjo përfshin dhe nënkupton informacion mbi të gjithë projektin dhe jo vetëm mbi pjesën e financuar me fonde nga AKKSHI-ja.
3. Përfituesi detyrohet të mbajë të gjithë dokumentacionin (duke përfshirë dokumentet financiare) lidhur me projektin të paktën 3 vjet pas përfundimit të tij. Gjithashtu është i detyruar të ofrojë akses në këto dokumente ndaj çdo monitorimi që kryhet nga AKKSHI apo çdo audit që kryhet nga institucionet përkatëse që kanë kompetencë kontrollin e shpenzimeve të fondeve publike.

Neni 10

Vizibiliteti

1. Përfituesi duhet të vendosë logon e AKKSHI-së mbi të gjitha pajisjet, materialet, faqet zyrtare të internetit dhe të tjera produkte të përgatitura në kuadër të projektit.
2. Në infrastrukturën kërkimore – shkencore të blerë me financimin e AKKSHI, përfituesi vendos mbishkrimin: “ Mundësuar me mbështetjen financiare të AKKSHI-së”.

3. Me lidhjen e kësaj kontrate, përfituesi automatikisht lejon AKKSHI-në të publikojë emrin e përfituesit, adresën, qëllimin e projektit, aktivitetet si dhe fondin e marrë, në çdo mënyrë që Agjencia e konsideron të dobishme.

Neni 11

Pronësia dhe përdorimi i infrastrukturës kërkimore – shkencore

1. Infrastruktura kërkimore – shkencore e blerë me financimin e AKKSHI-së është në pronësi të përfituesit të grantit dhe pjesë e inventarit të institucionit të arsimit të lartë si aktiv i qëndrueshëm.
2. Infrastruktura kërkimore – shkencore e blerë me financimin e AKKSHI-së mund të vihet në dispozicion të palëve të treta, kundrejt marrëveshjes ndërmjet palëve.
3. Infrastruktura kërkimore – shkencore e blerë me financimin e AKKSHI-së duhet të mundësojë përdorimin e saj nga komuniteti kërkimor – shkencor i interesuar, në përputhje me parimin e shkencës së hapur, (“open science”), sipas përcaktimeve të ESFRI² (European Strategy Forum on Research and Infrastructures) dhe objektivave strategjike të ERA³.

Neni 12

Ndryshimet e Kontratës

1. Ndryshimet thelbësore në mënyrën/metodën e realizimit të projektit mund të ndodhin vetëm pas miratimit nga Bordi i Administrimit të AKKSHI, pas paraqitjes së kërkesës zyrtare nga përfituesi me argumentimin përkatës.
2. Përfituesi i grantit njofton me shkrim AKKSHI-në në rast se ndodhin ndryshime në adresën, kontaktet, dhe numrin e llogarisë së përfituesit.
3. Çdo ndryshim tjetër në këtë Kontratë mund të bëhet vetëm nëpërmjet një akti shtesë të nënshkruar nga palët.

Neni 13

Ndërprerja e Kontratës

Kontrata mund të ndërpritet nëse:

1. Kjo Kontratë përfundon rregullisht sipas përcaktimit në Nenin 3 më sipër.
2. Përfituesi nuk zbaton projektin në cilësinë dhe sasinë e parashikuar në projektin objekt të kësaj Kontrate.
3. Kontrolli i Shtetit ose autoritete të tjera që sipas ligjit kanë të drejtë të kontrollojnë shpenzimet e fondeve buxhetore konstatojnë shkelje dhe kjo pranohet nga AKKSHI-ja.
4. AKKSHI mund të zgjidhë menjëherë këtë Kontratë, në rast se përfituesi shkel ndonjë prej detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë, apo në Legjislacionin shqiptar.
5. Ka Forca Madhore.

² <https://www.esfri.eu/forum>

³ https://ec.europa.eu/info/research-and-innovation/strategy/era_en

Neni 14

Shpenzime të lejueshme/të palejueshme

1. Të gjitha shpenzimet duhet të bëhen gjatë periudhës së zbatimit të projektit. Ato duhet të jenë reale dhe të lidhura me projektin e miratuar.
2. Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të lejueshme dhe nuk mbulohen me fondin e Grantit që financon Projektin:
 - a. Blerje e tokës.
 - b. Shit-blerje makinash.
 - c. Interes mbi huadhënie.
 - d. Marrëveshje huadhënie.
 - e. Dhurime.
 - f. Financim i partive politike apo organizatave e grupeve fetare.
 - g. Krijim i përfitimeve për anëtarët e Bordit, stafit apo të të afërmeve të tyre (përfshirë kompanitë në të cilat ato kanë interesa) nëpërmjet angazhimit në transaksione me ta apo të tjera shpërblime për pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të projektit.
 - h. Veprime në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 15

Sanksionet

1. Moszbatimi i detyrimeve për afatet e paraqitjes së raporteve financiare dhe atyre të programuara, sjell për pasojë në mënyrë të përshkallëzuar paralajmërimin e Përfituesit, ndërprerjen e financimit dhe përjashtimin nga financimi i projekteve për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
2. Në rast se fondet e financuara me anë të këtij Granti, nuk janë shpenzuar sipas zërave të buxhetit të miratuar në Planin Plotë të Buxhetit që shoqëron këtë kontratë, apo konstatohen shpenzime të palejueshme sipas nenit 14 të kësaj kontrate, shuma e shpenzuar në shkelje të kontratës do t'i kthehet buxhetit të shtetit.
3. Në rast të ndërprerjes së realizimit të projektit nga ana e IAL-së Përfituese, duke mos u kufizuar vetëm në shkaqet e parashikuara në Nenin 13 të kësaj kontrate, AKKSHI i drejtohet gjykatës kompetente për rikuperimin e fondeve të lëvruara të Grantit që janë të papërdorura dhe/ose të pajustificuara me dokumentacionin ligjor përkatës për kryerjen e shpenzimeve në kuadër të Projektit siç përmendet në Nenin 2 të kësaj kontrate.
4. Për shkeljet e përmendura në paragrafët 1-4 të këtij neni dhe kur nuk zbatohet asnjë afat i parapërcaktuar në këtë kontratë, AKKSHI-ja i drejtohet Gjykatës kompetente lidhur me mos përmbushjen e detyrimeve nga pala tjetër dhe zhdëmtimin eventual.

Neni 16

Zgjidhja e konflikteve

Në rastet e mosmarrëveshjeve midis palëve, ato do të kenë 30 ditë afat për zgjidhjen me mirëkuptim të konfliktit. Në qoftë se brenda kësaj periudhe nuk arrijnë në një marrëveshje, palët i drejtohen gjykatës kompetente.

Neni 17

Elementët përbërës të Kontratës

Në momentin e lidhjes, kjo kontratë duhet të përmbajë bashkëlidhur Projekt Propozimin e miratuar dhe buxhetin e rishikuar.

Neni 18

Të ndryshme

1. Ndryshimet dhe shtesat e kësaj Kontrate bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga palët e saj.
2. Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë të palëve dhe përcakton në mënyrë ekskluzive afatet dhe kushtet lidhur me objektin e saj.
3. Për çështje që nuk parashikohen specifikisht në këtë Kontratë, palët do t'i referohen akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Kjo Kontratë është hartuar dhe lidhur në 3 kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat 2 (dy) i mban AKKSHI-ja dhe 1 (një) Përfituesi.

Pasi u lexua nga palët, Kontrata nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë.

Kjo kontratë nënshkruhet nga :

Për AKKSHI-në:


Znj. Mirela Muça
Drejtori Përgjithshëm



Për Universitetin "Luigj Gurakuqi"
Shkodër

Znj. Rajmonda Këçira

Rektor



Znj. Lulzime Dhora
Drejtuessi i projektit



Nr.	Zërat e detyruar të zbatimit	Njësia	Sasia	Kosto		Totali	Shuma e kërkuar nga AKKSHI	Shuma e mbuluar nga shtipëtarët ose të tjerë	Përshkrimi i detyruar *
				per njësi	(në Lekë)				
	Shpenzime kapitale (të krye për laboratorin)								
1	Autotalizator për gjak të plotë	Copx	1	ALL	1,140,000.00	ALL	1,140,000.00	ALL	<p>Specifikimet Teknike: Diferencimi 3-gjeshësh i WBC; 20 parametra + 3 histograme</p> <p>Mënyrat e numërimit: Gjak i plotë, i paraboluar dhe periferik</p> <p>Parametrit: WBC, LYM%, MON%, GRA%, LYM%, MON%, GRA%, RBC, HCG, MCHC, MCH, MCV, RDW-CV, RDW-SD, HCT, PLT, MPV, PDW, PCT, P-LCR, Histogramet për WBC, RBC, PLT.</p> <p>Performanca: 60 mostra në orë</p> <p>Puritet: Rezistenca elektrike për numërimin e WBC, RBC dhe PLT</p> <p>Vëllimi i kampionit: Gjak i plotë 9.8 µl, i paraboluar 20 µl</p> <p>Diametri i hapjes: WBC 80 µm, RBC 50 µm</p> <p>Transportues: WBC/RBC/HGB < 0.5%, PLT < 1.0%</p> <p>Ruajtja e të dhënave: Deri në 50.000 rezultate të mostrave (përfshirë histogramet)</p> <p>Mënyja: Testi, Rezultatet, Informacioni i Sistemit, Kontrolli i Cilësisë, Kalibrimi, Shërbimi, Cilësimit</p> <p>Softueri: Anglisht, Spanjisht, Françezisht</p> <p>Elektri: Ekran me prekje LCD me ngjyra 10.4 TFT</p> <p>Hyjra/Dalja: RS232, USB, LAN, ndërfaqja e tashmë dhe reasit</p> <p>Printimi: Printer termik, letër me gjërësi 55 mm, format të shumta printimi, printer i jashtëm (opsionale)</p> <p>Mjedisi i funksionimit: Temperatura: 15°C-35°C. Lagështia: 10%-90%</p> <p>Kërkesa për energji: AC 100-240V, 50/60 ±1Hz</p> <p>Përmasat: 436 mm (H) x 363 mm (W) x 367 mm (D)</p> <p>Peshë: 18 kg. Reagentet e përshfite për procesin e validimit, bashkëshoqerues: Diuveni 20L</p> <p>Laser 0,5L</p> <p>Pastrues IL</p> <p>Extra Cleaner 100ml</p> <p>Kontrolli i hematologjis reagent kalibruar</p>

6	Kaqulometer	Cope	1 ALL	696,000.00 ALL	696,000.00 ALL	696,000.00 ALL	696,000.00 ALL	696,000.00 ALL	ALL	<p>4 kanale (4 detektore LED me jetëgjatësi dëni në parametra të ndryshëm) QC dhe programi i kalibrimit të integruar Rezultati i shumëfishitë duke përfshirë raportun g/ibepërfshirë të pacenut Funksioni i kontrollit automatik të ndezjes Përpjetë e lidhur në mënyrë elektronike</p> <p>Parimi: Drita e shpërndarë me analizë perqindjeje Kanali i testimit: 4 Kanale Burimi i dritës: Diodëtor i kondensueshem LED (470 nm) Koha e provës: Normalisht 20-60 sekonda, koha maksimale dëni në 600 sekonda Pozicioni i mostrës: 24 pozicione Pozicioni i reagjentit: 6 pozicione (1 përzierës magnetik i përfshirë) Min. Konsumimi i reagjentit: 25 ul për FTB, PT, APTT Kujtzica: Dëni në 10,000 rezultate të testit Nërditja: RS232, PSTN (opsionale) Ekran: LCD 6 inç Hyji: Paneli me prekje ose mouse Dalja: Printer i jashtëm (opsionale) Peshë neto: 8 kg Dimensionet LxWxH (mm): 410 x 310 x 160 Furnizimi me energji elektrike: AC 110 V - 220 V, +/- 10 % 50-60 Hz</p> <p>Reagjentet e koagulimit - PT-4S 10 x 5 ml - APTT (Acid Ellagic) 10 x 4 ml - Fibrinogen 2 x 2 ml - Klorur kalciumi 0.020 M 3 X 16 ml Plasma Control Nivelit 1 - 10 X 1 ml</p> <p>Me njësi ndërtimi profesional Koehler me një diafragmë të rregullueshme në terren si dhe një kondensator 1.25 Abbe të rregullueshëm në lartësi, i cili mund të përdoret dhe ka një diafragmë të rregullueshme të hapjes Sistem opuk Infinity</p> <p>Njësi rrezulluese e lënieve 5-fsh E pjeret sferenopof, e rrezullueshme 360° Kompensimi i dioptrisë (te dyja palët) Dimensionet e përgjithshme W-D-H 390 - 300 - 400 mm Peshë neto përfshirë: 8983 kg Okular: HMF 10x30 mm Cilësia objektive: Infinity E Plan Objektivat: 4x/10x/20x/40x/100x Ndërtimi: 3W LED (drita e transmetuar) Sensor CMOS 1/2.5", sistem operues: Win XP Win Vista Win 7 Win 8 Win 10. Kendi i tubave: 30 grade, transokulare. Nërditja: USB 3.0 (14.7 - 101.2 FPS) HWF 10- Ø 30.0 mm 4 x 10 x / 20 x / 40 x / 100 x</p>
---	-------------	------	-------	----------------	----------------	----------------	----------------	----------------	-----	--



21	F V Detanj per mbledhjen e shtabes EL3 5	m2	26.56	ALL	3,446.00	ALL	91,525.76	ALL	91,525.76	F V Detanj per mbledhjen e shtabes EL3 5
22	F V Javaman porcelani	copo	1.00	ALL	12,800.00	ALL	12,800.00	ALL	12,800.00	F V Javaman porcelani
23	F V tub -rak ushqetjesi PPR d=20-32 mm	ml	20.00	ALL	376.00	ALL	7,920.00	ALL	7,920.00	F V tub -rak ushqetjesi PPR d=20-32 mm
24	F V Tuba Ø 110 mm	ml	10.00	ALL	1,432.80	ALL	14,328.00	ALL	14,328.00	F V Tuba Ø 110 mm
25	Tuba plasmasi dhe rakordet	kg	25.00	ALL	667.00	ALL	16,675.00	ALL	16,675.00	Tuba plasmasi dhe rakordet
26	F V tub pligmasi Ø 11 - 13 mm	ml	20.00	ALL	214.00	ALL	4,280.00	ALL	4,280.00	F V tub pligmasi Ø 11 - 13 mm
27	F V tub pligmasi Ø 14 - 17 mm	ml	20.00	ALL	712.00	ALL	14,240.00	ALL	14,240.00	F V tub pligmasi Ø 14 - 17 mm
28	F V vresa shikua brenda muri 2 fazore 25 A "Gevis"	copo	20.00	ALL	158.00	ALL	3,160.00	ALL	3,160.00	F V vresa shikua brenda muri 2 fazore 25 A "Gevis"
29	F V perçelles 2 5mm2	ml	70.00	ALL	414.00	ALL	3,120.00	ALL	3,120.00	F V perçelles 2 5mm2
30	Kuti elektronike 3 modular	copo	8.00	ALL	802.00	ALL	6,416.00	ALL	6,416.00	Kuti elektronike 3 modular
31	F V vresa bivalente 220V 10A 2P-T Gevis	copo	10.00	ALL	632.00	ALL	6,320.00	ALL	6,320.00	F V vresa bivalente 220V 10A 2P-T Gevis
32	Celës i polior 10A	copo	10.00	ALL	1,143.60	ALL	11,436.00	ALL	11,436.00	Celës i polior 10A
33	F V kasete me 6 module	copo	1.00	ALL	1,143.60	ALL	1,143.60	ALL	1,143.60	F V kasete me 6 module
34	F V vresa d'alumini plasmasi me dopio sham	copo	15.70	ALL	14,520.00	ALL	227,964.00	ALL	227,964.00	F V vresa d'alumini plasmasi me dopio sham
35	Raft per Garderobe	copo	1.00	ALL	14,400.00	ALL	14,400.00	ALL	14,400.00	Raft per Garderobe
36	Banuk pune	copo	6.00	ALL	90,000.00	ALL	540,000.00	ALL	540,000.00	Banuk pune
37	Sul punes.Litumbj:lakst	copo	16.00	ALL	9,600.00	ALL	153,600.00	ALL	153,600.00	Sul punes.Litumbj:lakst
38	Kondicioner	copo	1.00	ALL	130,000.00	ALL	130,000.00	ALL	130,000.00	Kondicioner
39	Tavoline sendrone pedagoge	copo	1.00	ALL	39,600.00	ALL	39,600.00	ALL	39,600.00	Tavoline sendrone pedagoge
40	Karrige rrotuluese pedagoge	copo	1.00	ALL	28,800.00	ALL	28,800.00	ALL	28,800.00	Karrige rrotuluese pedagoge
41	Tavoline sendrone per studimet	copo	2.00	ALL	27,600.00	ALL	55,200.00	ALL	55,200.00	Tavoline sendrone per studimet
42	Banuk per Receptionin komplet + Raft	copo	1.00	ALL	180,000.00	ALL	180,000.00	ALL	180,000.00	Banuk per Receptionin komplet + Raft
43	Karrige rrotuluese per Receptionistin	copo	1.00	ALL	28,800.00	ALL	28,800.00	ALL	28,800.00	Karrige rrotuluese per Receptionistin
44	Karriga prijte	copo	6.00	ALL	9,000.00	ALL	54,000.00	ALL	54,000.00	Karriga prijte
45	Poltron mekanik per marrjen e gaktu	copo	1.00	ALL	216,000.00	ALL	216,000.00	ALL	216,000.00	Poltron mekanik per marrjen e gaktu
46	Grila dnuare	copo	2.00	ALL	9,600.00	ALL	19,200.00	ALL	19,200.00	Grila dnuare
TOTAL				ALL	11,079,769.96	ALL	8,000,000.00	ALL	3,079,769.96	
(Shuma e shprehurave te abstraktuara te Projektit)										

Drejtesia i Projektit
Dr. Lutjame DHORA



Administratori i Universiteti

Z. Adm. LIRUCI



Drejtesia i Zyres se Financës

Z. Ildir BEKTESMI




KALENDARI I AKTIVITETEVE

Projekti i Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor Viti 2023

Titulli i projektit: Laboratorin klinik-biokimik

Nr.	AKTIVITETI/MUAJI	VITI 2023							
		Korrik (31.07.2023)	Gusht (31.08.2023)	Shtator (30.09.2023)	Tetor (31.10.2023)	Nëntor (30.11.2023)	Dhjetor (28.12.2023)		
1	Draftimi i specifikimeve teknike për pajisjet e parashikuar në buxhet								
2	Realizimi i procedurës së tenderimit								
3	Lidhja e kontratës								
4	Blerja								
5	Instalimi i pajisjeve								
6	Vënia në punë e pajisjes/ve								
7	Trajnime të mundshme								
8	Raportime periodike dhe përfundimtare								

Veprimtari të kërkimit shkencor që priten të ndodhin si rezultat i instalimit të infrastrukturës së kërkimit shkencor.


AKTIVITETI	2024	2025	2026	2027	2028
A.1 Realizimi i punëve praktike dhe laboratorike nga studentët					
A.2 Studim i parametrave biokimikë në specie të ndryshme tek populata e peshqve të Liqenit të Shkodrës.					

Drejtesia e Projektit

Admir Uraei
 Administratori i Universitetit

Drejtuës i Zyrës së Financës

Shekela J. ...
 Rektori i Universitetit



A.3 Studim i shpërndarjes dhe raportei e grupeve të gjakut tek popullata e studentëve të USH.					
A.4 Studim i lidhjes së parametrave hematologjik, biokimikë ose hormonal dhe lidhja e tyre me sëmundshmërinë tek një grup popullate në rajonin e Shkodrës.					

KODEK



Drejtnesi i Projektit

[Handwritten signature]

Administratori i Universiteti

[Handwritten signature]

Drejtnesi i Zyrtës së Financës

[Handwritten signature]

Rektori i Universiteti

[Handwritten signature]

